

SHQIPËRISË
BASHKIA PRRENJAS

Nr. ____prot.

Prrenjas, më 17.09.2019

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Për: Operatorin ekonomik “Sark” sh.p.k me Nipt: K52531415H, me adrese: Fier, Lagjja 8 Shkurti, Rruga Skënderbej, Fier, Rajoni nr.3, perballe supermarket Lalaj, me administrator z. Arben Kajolli.

Procedura e prokurimit: Kërkesë për propozim - pune

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-33691-08-16-2019

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Shpenzime për lyerje meremetime, dizinfektim ambientesh Bashkia Prrenjas”

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike Buletini Nr. 34 datë 26.08.2019.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët **X** oferta ekonomikisht më e favorshme d

Fondi limit: 6,666,100 (gjashtë milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e njëqind) **lekë pa TVSH.**

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1.Operatori ekonomik “Elda VL” sh.p.k, me Nipt: **K67106202W**, me administrator Artan Hoxhaj, adresa: Vlorë L.H CAKERRI 88, **nuk ka paraqitur oferte ekonomike.**

2.Operatori ekonomik “NIKA” shpk, me Nipt **J76705047U**, me adresë: Shkoder Lagjja Vasil Shanto, Bulevardi Skenderbeu, godine 8-kateshe, kati i I-re, Zona kadastrale 8593, nr.pasurie 5/587”, me administrator Znj. Shpresa Nika, me ofertë ekonomike **4,529,259** (kater milion e pesëqind e njëzetë e nëntë mijë e dyqind e pesëdhjetë e nëntë) **lekë pa TVSH.**

3. Operatori ekonomik “SIRETA 2F” shpk, me Nipt: **K51501008J** me adresë: Tirane, Paskuqan, Lagjja Babrru Fushe, Komuna Paskuqan, me administrator Fatime Pali, me ofertë ekonomike **5,825,110 (pesë milion e tetëqind e njëzetë e pesë mijë e njëqind e dhjetë) lekë pa TVSH .**

4. Operatori ekonomik “Sark” sh.p.k me Nipt: **K52531415H**, me adrese: Fier, Lagjja 8 Shkurti, Rruga Skënderbej, Fier, Rajoni nr.3, perballe supermarket Lalaj, me administrator z. Arben Kajolli, me ofertë ekonomike **6,159,756 (gjashtë milion e njëqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH .**

5.Operatori ekonomik “Meni” sh.p.k me Nipt: **J61909018W** me adresë: Tiranë, Njësia Bashkiake Nr.8,

Rruga Shinasi Dishnica, Pallati UniCom Nr.1, Hyrja A, Kati 2-të me Administrator Z.Niat Liçi, me ofertë ekonomike **6,418,865 (gjashtë milion e katërqind e tetëmbëdhjetë mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH .**

6. Operatori ekonomik **“SPEKTRI”shpk**, me Nipt J62903555F, me adresë: Fier L. Konferenca Pezes, me administrator Robert Yzeiraj me oferte ekonomike **6,611,780 (gjashtë milion e gjashtëqind e njëmbëdhjetë mijë e shtatëqind e tetëdhjetë) lekë pa TVSH .**

7.**BOE “JODJON-PO shpk &“Restaurim Gurra-Kaca” shpk , “JODJON-PO” shpk** me Nipt:L18017601T, me administrator Fatmir Polisi, Elbasan Prrenjas dhe “Restaurim Gurra-Kaca” shpk, me Nipt:K87706601M, me administrator Tahir Kaca, me adresë: Elbasan Librazhd, me ofertë ekonomike **6,632,816 (gjashtë milion e gjashtëqind e tridhjetë e dy mijë e tetëqind e gjashtëmbëdhjetë) lekë pa TVSH.**

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1 Operatori ekonomik.**“Elda VL” sh.p.k**, me Nipt: K67106202W, me administrator Artan Hoxhaj, adresa: Vlorë L.H CAKERRI 88.

2. Operatori ekonomik **“NIKA” shpk**, me Nipt J76705047U, me adresë: Shkoder Lagjja Vasil Shanto, Bulevardi Skenderbeu, godine 8-kateshe, kati i I-re, Zona kadastrale 8593, nr.pasurie 5/587”, me administrator Znj. Shpresa Nika.

3. Operatori ekonomik **“SIRETA 2F” shpk**, me Nipt: K51501008J me adresë: Tirane, Paskuqan, Lagjja Babrru Fushe, Komuna Paskuqan, me administrator Fatime Pali.

4. Operatori ekonomik **“Meni” sh.p.k** me Nipt: J61909018W me adresë: Tiranë, Njësia Bashkiake Nr.8, Rruga Shinasi Dishnica, Pallati UniCom Nr.1, Hyrja A, Kati 2-të me Administrator Z.Niat Liçi.

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

1.S’kualifikimi i opertori ekonomik “ELDA VL” sh.p.k është bere per arsye se nuk ka paraqitur ofertë ekonomike.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit u konstatua se

- Nuk i plotëson kërkesat e përgjithshme për kualifikim.
- Nuk i plotëson kriteret e vecanta të kapacitetit ekonomik.
- Nuk i plotëson kriteret e vecanta të kualifikimit.
- Nuk i plotëson kriteret e vecanta të kapacitetit teknik.

OE nuk ka paraqitur oferte ekonomike dhe asnjë nga dokumentat e kërkuara në dokumentet e tenderit, referuar listës së kërkesave të tenderit, në mbështetje të nenit 66 të VKM Nr.914, datë 29.12.2014 “ Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar .

Në mbështetje me **Nenin 53** të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin publik” i ndryshuar si dhe Dokumentave Standarde të tenderit të miratuara, u konstatua se oferta e OE **“ELDA VL” sh.p.k nuk është në përputhje** me kërkesat e tenderit, duke e cilesuar **si ofertë të pavlefshme.**

2.S'kualifikimi i operatorit ekonomik "Nika" sh.p.k me ofertë ekonomike 4,529,259 (katër milionë e pesëqind e njëzet e nëntë mijë e dyqind e pesëdhjetë e nëntë) leke pa TVSH, perkatesisht per arsyet me poshte:

Nga shqyrtimi i dokumentacionit u konstatua se:

- I plotëson kërkesat e përgjithshme për kualifikim.
- Nuk plotëson kriteret e vecanta të kualifikimit.
- I plotëson kriteret e vecanta të kapacitetit ekonomik.
- I plotëson kriteret e vecanta të kapacitetit teknik.

Nga operatori ekonomik "Nika" sh.p.k është bërë ndryshim i zërave të preventivit përkatësisht atij nr.84 me nr.analize 2.404 "Bojë hidroplastike" ku sasia është shënuar 115 m² ndërkohë që në preventivin e publikuar nga AK sasia e këtij zëri është 155 m², duke ndryshuar strukturën e preventivit të kërkuar nga autoriteti kontraktor.

Në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me gabim aritmetik por jemi në kushtet e ndërhyrjes në sasi të preventivit, duke ndryshuar strukturën e preventivit të kërkuar nga autoriteti kontraktor referuar dhe argumentimit të Vendimit K.P.P. 241/2018.

Në mbështetje të nenin 53 e Ligjit 9643, datë 20.11.2006, "Për Prokurimin publik" i ndryshuar, nenit 66 të VKM-se nr.914 datë 29.12.2014 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, referuar Vendimin e KPP 241/2018 si dhe rezulton se oferta ekonomike nuk mund të korigjohet dhe se jemi në kushtet e ndërhyrjes në sasi të preventivit, si rezultat Komisioni konstatoi se oferta nuk është e vlefshme.

Nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje me **Nenin 53** të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, "Për Prokurimin publik" i ndryshuar si dhe Dokumentave Standarde të tenderit të miratuara, u konstatua se oferta e **"NIKA" sh.p.k nuk është në përputhje** me kërkesat e tenderit, duke e cilesuar **si ofertë të pavlefshme.**

3 S'kualifikimi i operatorit ekonomik "Sireta 2 F" sh.p.k me ofertë ekonomike 5,825,110 (pesë milion e tetëqind e njëzet e pesë mijë e njëqind e dhjetë) leke pa TVSH, perkatesisht per arsyet me poshte:

Nga shqyrtimi i dokumentacionit u konstatua se

- I plotëson kërkesat e përgjithshme për kualifikim.
- I plotëson kriteret e vecanta të kapacitetit ekonomik.
- Nuk plotëson kriteret e vecanta të kualifikimit.
- I plotëson kriteret e vecanta të kapacitetit teknik.

Operatorit ekonomik **"Sireta 2 F"** shpk është bërë një ndryshim i zërave të preventivit përkatësisht atij nr.29 me nr.analize 2.312 "Suvatim brenda mure guri h-4m me krah llac të përzier M-25" ku sasia është shënuar 70 m² ndërkohë që në preventivin e publikuar nga AK sasia e këtij zëri është 8 m².

Gjithashtu në formular oferte në nr.97 me nr.analize 2.399 "Sherbetosje e bojatisje me gelqere" ku sasia është shënuar 150 m² ndërkohë që në preventivin e publikuar nga AK sasia e këtij zëri është 140 m² ndërsa zëri 99 me nr.2.328 "Patinim muri me allci, stuko" sasia e kërkuar nga AK është 20 m² ndërkohë që OE ka ofertuar për një sasi prej 15 m².

Në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me gabim aritmetik por jemi në kushtet e ndërhyrjes në sasi të

preventivit, duke ndryshuar strukturën e preventivit të kërkuar nga autoriteti kontraktor referuar dhe argumentimit të Vendimit K.P.P. 241/2018.

Në mbështetje të nenit 66 e VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, referuar dhe Vendimin e K.P.P. 241/2018 si dhe në nenin 53 e Ligjit 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin publik” i ndryshuar, rezulton se oferta ekonomike nuk mund të korigjohet dhe se jemi në kushtet e ndërhyrjes në sasi të preventivit, si rezultat Komisioni konstatoi se oferta nuk është e vlefshme.

Nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje me **Nenin 53** të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin publik” i ndryshuar, u konstatua se oferta e OE **“Sireta 2 F” sh.p.k nuk është në përputhje** me kërkesat e tenderit, duke e cilesuar **si ofertë të pavlefshme.**

4.S’kualifikimi operatorit ekonomik **“MENI” sh.p.k** me ofertë ekonomike 6,418,865 (gjashtë milion e katërqind e tetëmbëdhjetë mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH, perkatesisht per arsyet me poshte:

Nga shqyrtimi i dokumentacionit u konstatua se

- Nuk i plotëson kërkesat e përgjithshme për kualifikim.
- I plotëson kriteret e vecanta të kapacitetit ekonomik.
- I plotëson kriteret e vecanta të kualifikimit.
- I plotëson kriteret e vecanta të kapacitetit teknik.

-Operatori ekonomik “Meni” shpk ka paraqitur vertetimin "Për Kontributet e Sigurimeve Shoqërore e Shëndetësore për Tatimpaguesin - E-SIG 02/a" me Nr.T01298046 datë 14.08.2019 nga i cili rezulton se OE ka 129,355 lekë detyrime për të paguar, duke mos plotësuar kështu një prej kriterëve të përgjithshme të percaktuara në dokumentat e tenderit.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se **oferta nuk përmban** të gjithë dokumentacionin e kërkuar në dokumentet e tenderit, referuar listës së kërkesave të tenderit, në mbështetje të nenit 66 të VKM Nr.914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje me **Nenin 53** të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin publik” i ndryshuar si dhe Dokumentave Standarde të tenderit të miratuara, u konstatua se oferta e OE **“MENI” sh.p.k nuk është në përputhje** me kërkesat e tenderit, duke e cilesuar **si ofertë të pavlefshme.**

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Operatorin ekonomik **“Sark” sh.p.k** me Nipt: K52531415H, me adrese: Fier, Lagjja 8 Shkurti, Rruga Skënderbej, Fier, Rajoni nr.3, përballë supermarket Lalaj, me administrator z. Arben Kajolli, se **oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej 6,159,756** (gjashtë milion e njëqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e gjashtë) **lekë pa TVSH** është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkisë Prrenjas sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 04.09.2019 .

Ankesa: Ka pasur ankesë në datë 06.09.2019. (është marrë në konsideratë ankesa dhe është bërë

rivleresimi në datë 06.09.2019) .

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 06.09.2019 .

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë 06.09.2019.

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

NURI BELBA